



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E**  
**TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2361/1 prot.

Tiranë, më 13.11.2024

Lënda: Mbi ribashkërendimin e projektligjit “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve”

**MINISTRISË SË BRENDSHME**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 2418/32 prot., datë 04.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 2361 prot., datë 05.11.2024, me anë të së cilës dërgoni për ribashkërendim projektligjin “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve” (në vijim “projektligji”) si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektligjit të ridërguar dhe dokumentacionit shoqërues, Zyra e Komisionerit vlerëson në tërësi marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë me shkresën nr. 1979/1 prot., datë 09.09.2024, të cilat janë përfshirë konkretisht në nenet 11/2 dhe 13 të tij.

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, ky projektligj konsiderohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, e për rrjedhojë Zyra e Komisionerit shprehet dakord me Projektligjin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**